

VENDIM
Nr. 265, datë 29.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.548, DATË 27.7.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE TË
PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN E PENSIONEVE SHTETËRORE
SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE
TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 15 e 17, të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 18, e vendimit nr.548, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“18) Personat e interesuar për të përfituar pagesë kalimtare apo pensione shtetërore suplementare duhet të paraqesin, përmes portalit qeveritar “*e-Albania*”, kërkesën për përfitim, ndërsa dokumentet origjinale dërgohen përmes shërbimit postar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore ku kanë vendbanimin.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj